



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1911 / prot.

VENDIM

Tiranë, më 04.07.2019

Nr. 41, datë 04.07.2019

PËR

**MIRATIM E KATEGORIVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT
ADMINISTRATIV TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të nenit 67 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe nivele të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve....", i ndryshuar, të VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative, në institucionet e arsimit të lartë", në vijim të propozimit të Senatit Akademik me Vendimin nr. 12, datë 11.02.2019 "Për miratimin e strukturës organizative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë", dhe të Vendimit të Senatit Akademik nr. 28, datë 28.02.2019 dhe të Vendimit nr. 42, datë 16.06.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 12, datë 11.02.2019 "Për miratimin e strukturës organizative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë", të shkresave të Administratorit nr. 782/2 prot., datë 13.03.2019 "Efektet financiare të strukturës së propozuar të UMT" dhe nr. 782/3 prot., datë 01.07.2019 "Mbi ndryshimet në efektet financiare të draft strukturës së propozuar", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kategoritë dhe nivelin e pagave të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Numri i personelit, si dhe kategorite dhe niveli i pagave është i ndarë sipas njësive shpenzuese referuar tabelave bashkëlidhur dhe pjesë integrale të këtij vendimi.
3. Për nivelin e pagës së personelit ndihmës akademik me karakter akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ, do të zbatohet legjislacioni në fuqi.
4. Ngarkohen të gjitha strukturat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËS KRYETARI
Florian TOTI